



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 9624 Prot.

Fier më 22/08/2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. 80, datë 22/08/2025

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E PASTREHË , QË KËRKON TË PËRFITOJË NGA SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREGUN E LIRË DHE NUK KA TË ARDHURA PËR TË PËRBALLUAR VLERËN E QIRASË ”

Këshillit të Bashkisë Fier , sot më datë __/08/2025 i paraqitet për shqyrtim materiali nga Komisioni i strehimit, i cili pasi shqyrtoi kërkesën emergjente për trajtimin me programin social të strehimit subvencionimit të qirasë në tregun e lirë ,të familjes Znj.Juela Meta , familje e pastrehë me kushte sociale , ekonomike emergjente si dhe pasi shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin administrativo-ligjor përkatës, në mbështetje të Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”,i ndryshuar, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr.301, datë 15.04.2021, “Për normat e strehimit”, VKB Nr.128 , datë 26/11/2024 “ Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social të strehimit “Subvencionimi i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë , nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij “ për vitin 2025 , VKB nr. 129, datë 26/11/2024 , Nr.12238/2 Prot , datë 05/12/2024 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe miratimin e vlerës mesatare të qirasë në tregun e lirë, për efekt të llogaritjes së masës së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij për vitin 2025”, vlera e subvencionit të qirasë për këtë familje, do të jetë në vlerën e përcaktuar sipas kontratës së qirasë Nr.repertori:2593 Nr.koleksioni 1124 datë 11.08.2025 e cila përballohet e plotë nga buxheti i Bashkisë Fier , VKB -së Nr.139, datë 23/12/2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 , VKB-së Nr.06, datë 31/01/2025 “ Për shtesë nga të ardhurat e trashëguara në buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2025” të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,i ndryshuar, neni 54 , gërma “k” , komisioni i strehimit :

Propozon :

1. Të miratoje familje përfituese të programit social të strehimit , të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë familjen e pastrehë të znj.Juela Meta , e cila nuk ka të ardhura ekonomike për ta përballuar vlerën e qirasë në tregun e lirë , sipas tabelës:

Nr	Emër Mbiemër	Përbërja familjare	Struktura e Ap.Sipas Normave të Strehimit	Kategoria "a" sipas ligjit 22/2018 "per strehimin social"	Të ardhurat familjare	Aftësia përballuese	Qiraja e përballueshme	Subvencioni (në lekë)	Subvencioni i tatimit (15%) (në lekë)
1	Juela Meta	9 anëtarë	3+1	Neni 2 pika 45/ç	0	0%	0%	20.000	3.000

- Subvencioni i qirasë sipas pikës 1, do t'i jepet familjes përfituese nga momenti i miratimit dhe i hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit Bashkiak.
- Efektet financiare sipas pikës 1, do të mbulohen në masën 100% nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Komisioni i Strehimit

- Pranvera Çina
- Melsi Bogdani
- Merita Bitri
- Elvi Daka
- Themion Mile
- Endri Jaupaj
- Kreshnik Dapi
- Rrapi Gjika
- Denisa Azizaj

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVËNDËS KRYETAR

VASIL BREGU

